



# PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E AKTIVITETIT TË GRUMBULLIMIT TË VAJRAVE USHQIMOR TË PËRDORUR

**PËR SUBJEKTIN SHOQËRIA R.O.V.E shpk**

*Përgatitur nga Departamenti i Gjeomjedisit - G & G group*



## **Autorë:**

Prof.	Sazan	GURI	(Ekspert hidrogjeolog)
	Ismail	HYSA	(Eksperte Mjedis)
M. Sc.	Marianthi	GURI	(Ekspert gjeo-mjedis)
M. Sc.	Denisa	BALO	(Ekspert Shendetit Publik)
Ing.Dipl.	Boralda	SHAMETI	(Eksperte Mjedis)
	Edona	MASATI	(Biologe)

**Tiranë, Shtator 2018**

## **PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TË PROJEKTIT**

Qëllimi i projektit konsiston në grumbullimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e përkohshme të vajrave ushqimor të përdorur në mjedise të sigurta dhe gatitjen për eksport duke përmbytur të gjitha kërkesat në bazë të kushteve teknike, mjedisore dhe të direktivave të Bashkimit Evropian. Aktivitetet që do të realizojë kompania R.O.V.E. *sh.p.k.* janë si më poshtë;

a) ambalazhimin në enë të veçanta për eksportimin e vajrave të përdorura, ose te subjekti që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e vajrave ushqimor të përdorur;

b) Paisja e ambalazheve të vajrave ushqimor të përdorur me simbolin që tregon se ato janë prodhuar në atë mënyrë që nuk pengon rigjenerimin, rikuperimin dhe asgjësimin e kontrolluar të tyre.

Shërbimi i grumbullimit, ambalazhimit, etiketimit dhe ruajtjen e përkohshme të vajrave ushqimor, ndërmerret si një iniciativë, që do të tentojë edhe në:

### **Impaktet pozitive shoqërore dhe mjedisore**

1. Ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të menaxhimit të vajrave ushqimor të përdorur me standarde ekologjike;
2. Mbledhjen e vajrave ushqimor të përdorur dhe ambalazhimin në enë të veçanta;
3. Prgatitjen për eksportimin e vajrave të përdorura sipas standarteve të kërkuara;
4. Mirëmbajtjen e ambalazheve dhe magazinës së grumbullimit vajrave ushqimor të përdorur;
5. Mbajtjen pastër të mjedisit përreth dhe në standarte të kënaqëshme, pa shkaktuar ndotje, duke ruajtur kushtet ekologjike të zonës;
6. Trainimin e personelit në shërbime të këtij aktiviteti;
7. Ruajtjen e vlerave dhe parametrat ekologjike të mjedisit.
8. Fuqizim të komunitetit për veprime në mbrojtje të mjedisit;
9. Zbatimin e rregullores së sigurimit teknik;
10. Rritjen e mundësisë për të përdorur shërbimet në investime mbi menaxhimin e mbetjeve të vajrave ushqimore të përdorura.

### **Objektivat e studimit janë:**

- të jap një gjendje sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të këtij zhvillimi ekonomik, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore gjatë menaxhimit të tyre;
- dhënien e masave zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve negative;
- planin e menaxhimit dhe monitorimet për zërat përkatëse.

### **Metodologjia e përdorur**

Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin. Për realizimin e studimit të VNM-së u kryen:

**a.** Vrojtime në terren në rajon të gjerë, duke kryer vrojtime pedologjike, gjeomorfologjike, si edhe ekologjike. Gjatë vrojtimeve në terren, kujdes i'u kushtua situatës për rreziqet natyrore rreth zonës në studim. Për realizimin e objektivave të këtij studimi janë marrë:

- Foto në territorin në studim;
- Takime me ekspert lokal dhe komunitetin e zonës;
- takime me Bashkinë dhe ekspertët e saj;

**b.** Argumentim i bazuar mbi vlerësimin e:

- Inventarët e të dhënave ekzistuese;
- Studimeve paraprake hidrogjeologjike;
- Studimi dhe skema e zhvillimit teknologjik;
- Informacionet bazë në botimet periodike mbi këtë zonë;
- Pajtuueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme, mbetjet e rrezikshme, zonat e ndotura.

**c.** Vlerësimin me metodën e listë-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-).

**d.** Vlerësimin e burimeve kryesore, për vlerësimin e ndikimeve të funksionimit të këtij aktiviteti janë:

- Mbajtja pastër e mjedisit përreth dhe në standarte të kënaqshme, pa shkaktuar mbetje ose ndotje, për të ruajtur kushtet ekologjike të zonës;
- Vlerësimi i sigurisë për rrjedhjen e çfarëdolloj ndotjeje në tokë dhe në ujërat nëntokësore
- Përdorimi i ujit të pijshëm, duke siguruar ujë në standarte europiane;
- Zbatimi i rregullores së sigurimit teknik të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit do të kryhet në bazë të standarteve europiane, me anë të impiantit të posaçëm të MKZ;
- Sistemi elektrik do të jetë i siguar me sistem mbrojtës;
- Mbrojtja e kushteve ekologjike sipas standarteve;
- Krijimi i sipërfaqeve të gjelbra përreth godinës së magazinimit.

### **Vlerësimi i situatës**

Për të ngritur një infrastrukturë miqësore me mjedisin, sikundër dhe rajoni e ka në ADN e vet, kërkohet të merren në konsideratë disiplina e fusha si;

- Kuadri administrativ,

- Plani rregullues egzistues (realizimet dhe mosrealizimet, struktura ekzistuese e fshatit, zonimi dhe identifikimi i nevojave);
- Pozicionin gjeografik i objektit dhe kufijtë e tij;
- Relievi i azhornuar, të dhëna gjeologjike dhe gjeomorfologjike;
- Të dhëna hidro-gjeologjike, të dhëna klimatike dhe hidrologjike;
- Të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës në studim;
- Raporti ndikimit në mjedis;
- Kushtet sizmike e tektonike të rajonit;
- Burimet territoriale dhe ekonomike;
- Popullsia (gjëndja ekzistuese dhe tendecat e ndryshimeve);
- Pronësia mbi trojet, Strehimi, Arsimi;
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale;

**Studimi strukturohet në zhvillimin e fazave kryesore si:**

- Ngritja e objektivave orientues të projekt-studimit;
- Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;
- Hartimi i projektit dhe dorëzimi tek porositësi si dhe subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele lokale.

***Aktivitetet e ekipit të vleresimit kanë përfshirë:***

- Rishikimin e kornizës ligjore dhe Shqyrtimin e dokumenteve relevante mjedisore;
- Procedurat e punës, listat kontrolluese, procesverbalet e ndryshme të institucionit;
- Konsultimin e literaturës së gjerë rreth strategjisë së menaxhimit të mbeturinave duke analizuar praktika dhe studime të kryera nga organizata të ndryshme ndërkombëtare;
- Vëzhgimin fizik të objekteve dhe observimet (të dokumentuara me foto) në vendndodhje.



*Pamje nga Google të zonës në studim ku ngrihet godina (© S. Guri, 2018)*

Pikat	X	Y
1	43 96 300	45 79 500
2	43 96 330	45 79 470
3	43 96 280	45 79 400
4	43 96 260	45 79 425

## PLANIMETRITË E VENDNDODHJES

Ky seksion i studimit paraqet rezultatet e një vlerësimi të dimensioneve të zonës së studimit dhe përshkruan kushtet përkatëse fizike, biologjike dhe social-ekonomike, duke përfshirë edhe ndonjë ndryshim para se të filloje projekti. Vlerësimi merr në konsideratë aktivitetet aktuale të zhvillimit dhe ato të propozuara brenda zonës së projektit



ose që nuk lidhen direkt me projektin. Siç mund të lexohet në dokumentacionin e bashkangjitur, territori është sipërfaqe fushore në territorin e Bashkisë Tiranë dhe nuk ka probleme pronësie. Në këtë zonë nuk kryhet as aktivitet bujqësor prej familjeve përreth zones. Rajoni në studim karakterizohet nga pika të forta dhe të dobëta, që lidhen me demografinë dhe situatën shoqërore, strukturën ekonomike, zhvillimin hapësinor dhe përdorimin e tokës, infrastrukturën sociale, teknike dhe kushtet natyrore dhe mjedisin, kuadrin e përgjithshëm dhe institucionet.

### **Relievi dhe topografia e rajonit**

Vend-ndodhja e zgjedhur në kilometrin e tretë të autostradës Tiranë - Vorë, e cila është një kompleks ndërtimi (Foto-1), me sipërfaqe rreth 100m<sup>2</sup>, në rajonin e Komunës Kashar. Vend-ndodhja është në një zonë fushore industriale me objekte dhe aktivitete ekonomike të tjera të ngjashme me rastin në studim.

### **Vendndodhja e zonës së studiuar**

Territori përreth është kryesisht i pjerrët, me një pjerrësi rreth 30% nga lindja në perëndim, ndërsa magazina ngrihet mbi një sipërfaqe të sheshtë. Rajoni në studim karakterizohet nga pika të forta dhe të dobëta, që lidhen me demografinë dhe situatën shoqërore, strukturën ekonomike, zhvillimin hapësinor dhe përdorimin e tokës, infrastrukturën sociale, teknike dhe komunale, kushtet natyrore dhe mjedisin, kuadrin e përgjithshëm dhe institucionet. Rajoni ndodhet shumë pranë kryeqytetit. Zhvillimi i qëndrueshëm në rajon do të jetë udhëzuesi kryesor për ndërhyrjet. Për këtë duhet që konsideratat ekonomike, shoqërore e ekologjike të ekuilibrohen me mirë zhvillimin rajonal.

## **INFORMACION PËR QËNDRAT E BANUARA**

### **Pozita gjeografike**

Zona në studim bën pjesë në njësinë fiziko-gjeografike të Ultësirës Bregdetare, Komuna Kashar. Në përgjithësi kemi të bëjmë me një rajon kodrinoro-fushor me një lartësi mesatare rreth 200m mbi nivelin e detit në këte komunë. Ky sektor konsiderohet si zonë e organizuar, për zhvillimin si zonë industriale dhe shërbimi. Relievi me forma nga më të larmishmet dhe luginat njëra më e bukur nga tjetra, ndërtimet, lokalet afer rrugeve auto mobilistike, zakonet tradicionale, mikpritja dhe kultura e banorëve vendas, afërsia me kryeqytetin e vëndit, etj, të gjitha këto në harmoni me njëra tjetrën ofrojnë mundësi të shumta potenciale ekonomike për gjithë këte zone.

### **Përdorimi aktual i tokës**

Territori, ku do të magazinohen keto vajra ndodhet pranë autostradës Tiranë – Durrës në kilometrin e 8-të nën administrimin e Komunës Kashar. Zona në të cilën gjendet kjo pikë është një zonë industriale me objekte të ngjashme shërbimi. Vendi ka një sipërfaqe rreth 125m<sup>2</sup> dhe gjendet në një zonë të sheshtë. Sheshi i objektit në veri kufizohet nga autostrada Tiranë-Durrës në lindje, perëndim e jug me pronare të tjerë privat, kryesisht njësi pika e

grumbullimit. Për të dhënë një gjendje sa më të plotë të Mjedisit janë kryer punime në terren, si verifikim habitatesh, janë mbledhur të dhëna për florën dhe faunën, janë marrë takime me ekspertët lokal dhe komunitetin, janë rivlerësuar inventaret dhe të dhënat ekzistuese, si dhe janë shfrytëzuar, informacionet bazë, në botimet mbi këtë zonë. Zbatimi i masave zbutëse, të dhëna në këtë studim, mbeten detyrim i firmës investuese.

### **Toka dhe bimësia**

Në zonën ku ngrihet magazina ka pak bimësi dhe ajo që ndodhet aty është kryesisht e ulët. Kjo lloj bimësie është karakteristike e kësaj zone. Tokat janë formuar në kushtet e ndërtimit litologjik prej argjilash, konglomeratesh e ranorësh, në kushtet e klimës mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë dhe dimër të butë dhe të lagësht, në kushtet e një mbulesë optimale bimore mesdhetare, të përfaqësuar prej shkurresh mesdhetare. Territori karakterizohet nga prania e tokave të hirta kafe të zhvilluara mbi depozitime aluvionale të Quaternarit, që shpesh kanë një ndërthurje të shtresave me përbërje mekanike të ndryshme. Një dukuri e tillë është rezultat i depozitimeve të vazhdueshme me orgjine minerale dhe organike. Në këto toka, ku mbulesa bimore është tipike e shkurreve mesdhetare, për shkak të zhvillimit të erozionit, profili tokësor është jo i plotë dhe horizontet tokësore nuk dallohen qartë. Tokat e larta dhe të pjerrta karakterizohen nga një shtresë humusi relativisht i cekët, ndërsa pjesa e poshtme ka një horizont humusor, që arrin 20-30cm. Këto toka deri në kufirin fushor kanë cilësi të mira kullimi dhe janë të përshtatshme për kultivimin e drurëve frutorë.

### **Pyjet dhe Kullotat**

Në zonen tone, pyjet dhe kullotat zënë një peshë të rëndësishme në kuptimin e sipërfaqes dhe rëndësisë së tyre. Vlerat e tyre qëndrojnë në larminë e bimësisë dhe të kafshëve që rriten aty si, dhe në aftësinë kullimore të tyre. Para viteve 90 në një sistem ku buqësia ishte thelbësore, u pa si mundësi prerja e pemeve dhe çpyllezimi duke i kthyer në toke buqësore. Pas viteve 90, një sipërfaqe e konsiderueshme u përmirësua gradualisht duke u pyllezuar në mënyrë natyrore.

### **Tokat bujqësore**

Elementët kryesor që diktojnë cilësinë e një toke e që lidhen drejtpërdrejt me rendimentin e cilësisë së tokave janë: përbërja mekanike, trashësia e horizontit humusor, përmbajtja e humusit, shkalla e pH dhe përmbajtja e fosforit. Ndryshimi i rendimentit të bimës nën ndikimin e trashësisë së horizontit humusor lëviz nga 20-30%. Siç e përmendëm, toka bujqësore nga pikëpamja e gjendjes faktike rezulton e pakësuar si rezultat i shpronësimeve nga prekja e ndërtimit të autostradës dhe rrugëve dytësore, duke pakësuar ndjeshëm fondin e tokës arë me tendencë zbritje si pasojë e ndërtimeve me karakter ekonomik.

## **SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE**







## **PËRSHKRIM I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE**

### **Projekti tekniko – teknologjik i pikës së grumbullimit të vajrave**

Projekti shqyrton zhvillimin e aktivitetit të grumbullimit, ambalazhimit, etiketimit dhe eksportit të vajrave ushqimor të përdorur, që do të jetë edhe objekti kryesor i shërbimeve të kësaj magazine. Sipërfaqja e kompleksit është 125m<sup>2</sup>. Në këtë mënyrë, ajo krijon kushte dhe premise të kryerjes me cilësi të këtij shërbimi. Me këtë koeficient zënie territori krijohen premisa për të organizuar ambalazhimin, grumbullimin, ruajtjen deri në kohën e gatitjes për eksport, për të realizuar kushtet teknike të magazinimit në këto godine. Në aspektin Urbanistik, objekti respekton distancat nga objektet ekzistuese kufiri i pronës, ai i rruges, etj. Objekti është projektuar me synimin për të realizuar një godine që, nga pikepamja e zgjidhjeve teknologjike të realizuara materialisht, duke krijuar njëkohësisht një konfort ambjental dhe po ashtu të kursimit të burimeve energjitike. Shërbimet në këtë pike kryhen në përputhje me procedurat dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport.



Të dhënat teknike të zgjidhjes së ambienteve të godinave respektojnë rigorozisht ato të kushteve optimale të shërbimit, dhe ka një hapje të konsiderueshme të godinës në drejtim të diellezimit, si dhe te kontaktit me ambjentet e gjelberuara përreth. Objekti që vendoset në këtë zonë është konceptuar me volume, që për mendimin tonë, realizojnë kohezionin me pelhuren urbane ekzistuese dhe atë të perspektives karakteristike. Shoqëria mundëson zhvillimin e aktivitetit të grumbullimit, depozitimit, dhe eksportit të vajrave të përdorur ushqimor, duke përfshirë dhe pajisjet përkatëse të ruajtjes së tyre si rezervuarë e bidona duke filluar nga 10 deri në 1000 litra, ku do të jenë 10 të tilla. Staf i profesional i kompanisë është i kualifikuar në menaxhimin e mbetjeve të vajrave ushqimorë të përdorur, por gjithashtu dhe në konsultim dhe orientim në perzgjedhjen e sakte të produktit për të plotësuar çdo kërkesë të klientëve. Në ambientet e kompanisë do të magazinohen rreth 10,000 litra. Mallrat që grumbullohen nga kompani prodhohen nga kompanitë e shërbimeve për konsumatorë.



Të dhënat teknike të zgjidhjes së ambienteve të godinës respektojnë rigorozisht ato të kushteve optimale të shërbimit, si në ambientet e pikës së grumbullimit, ashtu edhe në ambientet e sistemimit, etiketimit dhe ruajtjes, si dhe përfshin procesin e fundit, i cili është eksporti i mbetjeve të riciklueshme, të mallrave me përmbajtje vajore ushqimore të përdorura.



### **Grumbullimi të vajrave të përdorur ushqimor**

Projekti shqyrton zhvillimin e aktivitetit të grumbullimit, ku lënda e parë, merret nga aktivitete të tjera të ndryshme në bazë të kërkesës. Objekti përbehet nga një hapësirë e konsiderueshme e pajisur me konteniere, në të cilat depozitohet vaji. Në këtë mënyrë, ajo krijon kushte dhe premise të kryerjes me cilësi të këtij shërbimi. Vajrat që do të grumbullojë kompania do të jenë:

- Vaj fastfood
- Vaj ushqimor
- Vaj restorantesh
- Vaj vegjetal

Mbetja	Numuri i katalogut	Trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Lidhje kontrate për Eksportim
Mbetje që dalin nga përgatitja dhe përpunimet e ushqimeve	02	Nuk kryhet trajtim i mëtejshëm në vendndodhje	Realizim i eksportit në destinacionet e percaktura në kontrata të lidhura

## Stacionimi

Nje nga proceset që do te ndermarrë ky aktivitet do te jete procesi i stacionimit ose vendqendrimit te vajit në magazinën e percaktuar. Shoqëria do të mundesojë zhvillimin e aktivitetit të grumbullimit, depozitimit, dhe eksportit të vajrave të përdorur ushqimor, duke përfshirë dhe pajisjet përkatëse të ruajtjes së tyre në të cilën janë instaluar:

1. Rezervuarë vaji  $10 \times 1\text{m}^3 = 10\text{m}^3$ ;
2. Estakada për ngarkimin e autocisternave;
3. Vend-shkarkimi i autocisternave;
4. Pajisje për shuarjen e zjarrit (fikse të llojeve dhe madhësive të ndryshme, me shkumë, gaz karbonik dhe rërë kuarcore);
5. Muri rrethues i objektit për ta mbrojtur nga rrëshqitjet e mundëshme të dheut;
6. Tubacione, saracineska dhe pajisje për rezervuarë si p.sh. valvula sigurimi, valvula moskthimi dhe valvula të frymëmarrjes së rezervuarëve;
7. Aneksa të tjera sociale dhe ekonomike që i shërbejnë kësaj pike.

Rezervuarët sipërfaqësorë janë të tipit horizontal plastik me kafaz hekuri, e cila shërben për izolimin e vajit në rast avarie. Janë të pajisura me valvula sigurie dhe frymëmarrje, dhe sipas grafikut bëhet kolaudimi dhe shërbimi profilaktik i tyre, për të garantuar shfrytëzimin normal të rezervuarëve. Përveç këtyre pajisjeve janë edhe lidhjet teknologjike dhe aksesorët që shërbejnë për realizimin e procesit teknologjik të cilat janë:

- armatura për hapjen dhe mbylljen e rezervuarit,
- valvula moskthimi,
- tubacionet ndërlidhëse të rezervuarëve me saracineskat dhe pompat

## Skema teknologjike funksionon në këtë mënyrë:

- ✚ Para se autoçisterna të hyjë në pikën e shkarkimit, kontrollohet teknikisht ku këtu përfshihet kontrolli i rrjedhjeve eventuale nga autocisterna,.
- ✚ Pasi konstatohen se autoçisterna është në rregull lejohet të hyjë në vendshkarkim. Lidhja midis autoçisternës dhe nyjes së shkarkimit të kolektorit të rezervuarëve është e garantuar dhe funksionon në mënyrë të kontrolluar për shkarkimin e vajit sipas llojit në rezervuarin përkatës.
- ✚ Pasi sigurohet hermeticiteti bëhen manovrimet në hyrje të pompës dhe hyrjes së rezervuarit. Vihet në funksionim pompa duke hapur gradualisht saracineskën e daljes së pompës, fillimisht me numër të vogël filetosh për të mos krijuar dallgëzime në rezervuarë, pastaj bëhet hapja totale e saracineskës. Mbasi mbaron shkarkimi, bëhet mbyllja e manovrimeve të kryera duke i vendosur ato në pozicion normal.

- ✚ Ky proces është i vlefshëm edhe për rastet kur bëhet ngarkimi i autoçisternave, por në këto raste kushtohet kujdes i veçantë funksionimit të valvulës së frymëmarrjes, sepse në qoftë se ajo nuk funksionon, gjatë ngarkimit krijohet vakum i thellë në rezervuar dhe shkakton deformimin ose palosjen (rrudhosjen) në rezervuar.

### **Largimi**

Procesi i fundit është largimi i vajit për eksport me qëllim përfitimin e tij për ta përdorur për qëllime energjitike dhe industriale.

### **Lënda e parë**

Kompania do të grumbullojë dhe do të ambalazhojë vajin ushqimor të përdorur në bidona plastik dhe rezervuar plastik duke filluar nga ata 10 litrosh deri në 1000 litrosh nga importi. Konkretisht këto janë prodhime bashkëkohore italiane të një cilësie shumë të mirë.



### **Pika e kontrollit**

Objekti në vetvete nuk ka karakterin e një objekti prodhues, në të cilin ndodhin procese fiziko-kimike të transformimit të lëndës së parë në produkt të gatshëm. Gjatë këtyre cikleve bëhet kontrolli i ecurisë së punës. Radha e punës parashikohet të jetë si më poshtë:

- 1) Përgatitja e pikës së grumbullimit;
- 2) Kontrolli i pajisjeve mbajtëse;
- 3) Kontrolli i vendeve të punës;
- 4) Kontrolli i sistemit të sigurisë;
- 5) Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarrit;

### **Punësimi**

Stafi profesional i kompanisë është i kualifikuar, por gjithashtu dhe në konsultim dhe orientim në përzgjedhjen e saktë të produktit për të plotësuar çdo kërkesë të klientëve.

### **Marrëdhëniet me komunitetin**

Shtëpitë më të afërta me magazinën që janë 4-5 të tilla ndodhen në distancë mbi 150 metra. Banorët e tyre nuk kanë asnjë ankesë me magazinimet e mallarve deri me tash.

## **PROJEKTI NDERTIMOR I PUNIMEVE TEKNIKE**

### **Projekti Ndërtimor të zonës në studim**

Ndërtimi i objektit është realizuar me punime ndërtimore dhe metalike, për të realizuar lehtësirat në funksionimin e magazinimit të vajrave të përdorur ushqimorë, me anë të të cilave kryhen ruajtjen e perkohshme deri në kohën për eksportimin e këtyre vajrave. Këto arsye bëjnë, që në përbërjen e projektit një vend të veçantë zë përgatitja e bazamentit, ku

vendosen këto pajisje ambalazhi. Qëndrueshmëria e jetëgjatësisë së objektit, të ndërtuar është siguruar, duke përcaktuar shtresat e përshtatshme për taban, të themeleve e kollonave, mënjanimi i ujrave sipërfaqësore, përdorimi i materialeve të ndërtimit me cilësi e standarte ndërkombëtare, si dhe cilësia e punimeve të ndërtimit të objektit. Për t'u mbrojtur nga forcat goditëse të tërmeteve të pritshëm, në projektin e ndërtimit janë marë masa antisizmike, në përputhje me përcaktimin e rrezikut sizmik. Godina e magazinës është nertuar mbi një shesh të sistemuar dhe të përshtatur posaçërisht me kuota dhe elemente topografikë. Ky projekt paraqet një tërësi nyjesh dhe lidhjesh teknologjike, që bëjnë të mundur lëvizjen e automjeteve nga një vend në tjetrin dhe magazinimin deri ne kohen per largimin për eksport.

### **Koha e mundshme e përfundimit te funksionimit të projektit**

Koha e funksionimit të këtij aktiviteti është e pacaktuar, por ajo është në varësi të marrëdhënieve që vet subjekti do të ketë me instancat e institucioneve publike si AKM, ISHP etj të cilët bëjnë edhe monitorimin e vazhdueshëm dhe kontrollin e standarteve të menaxhimit të mbetjeve të vajrave ushqimorë të përdorur.

### **Faza e planifikuar e rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të projektit.**

Pemet frutore nuk do preken. Rrenjet dhe bimet e tjera nuk do shkulen me qellim parandalimin e erozionit sipërfaqësor, por do të gjelberohen pergjatë gjithë gjatësisë së magazinës. Masat adekuate do merren per parandalimin e humbjes apo demtimin e gjese se gjalle gjate ekzekutimit te puneve dhe deri ne rivendosjen e gardheve, mureve, pengesave, dhe portave. Te gjitha materialet e teperta do hiqen dhe vendi do lihet ne kushte te pastra dhe te rregullta. Rregullat dhe procedurat e meposhtme do te respektohen me kujdes per te mbrojtur mjedisin:

- Duke trajtuar mbeturinat ne perputhje me ligjin aktual te rregullores mjedisore nga autoritetet lokale shqiptare.
- Duke depozituar te gjitha pajisjet e çmontuara qe permbajne substance te rrezikshme ne vende te percaktuara nga autoritetet lokale, te cilat jane te mbrojtura nga rrjedhjet.



### **Mbrojtja e bimesise**

Parandalimi dhe kontrolli i erozionit është kerkesë thelbesore për shmangien e permbytjeve nga reshjet e dëndura, si dhe ndaj erozionit të ujrave sipërfaqësore. Pemet frutore nuk do preken. Rrenjet dhe bimet e tjera nuk do shkulen me qellim parandalimin e erozionit sipërfaqësor, por do të gjelberohen me mbjelljen e pemëve dekorative. Djegia në magazinë ndalohet rreptesisht. Ulluqet dhe rrepirat do të zhduken, demtimet e kanaleve, tarracave,

rrugeve dhe veçoritë e tjera të tokës do të korrigjohen, dhe toka do kthehet në kushtet e saj sipas projektit teknik.

## **TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA**

### **Sasia e ujit të nevojshëm**

Nuk kërkohet ujë për përdorim teknik apo për proces teknologjik, me përjashtim të nevojave vetjake të punonjësve, që normalisht do jetë 10-15 litra në ditë për person. Ky ujë do merret nga rrjeti, me të cilët kompania ka lidhur kontratë. Sic u theksua edhe më sipër, furnizimi me ujë bëhet nga rrjeti në baze të kontratës dhe pike lidhjeje i lëshuar nga Ujësjetësi Kanalizim, Tiranë sic tregohet bashkangjitur edhe në dokumentacion. Kjo pike lidhjeje është përcaktuar me objekt magazinim e vajrave ushqimore.

### **Sasia e energjisë**

Sasia e energjisë e nevojshme për funksionimin e kësaj magazine është rreth 10 kWh/ditë, gjë që vërtetohet me faturat e pagesës që biznesi kryen çdo muaj.